

RENDI I DITËS

Projektvendimi "Për miratimin e Udhëzuesit për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në Zonën e Administrimit Zgjedhor, në ndihmë të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021".

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-------|----------------------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Y. Merkaj, A. Tenolli, E. Numani |

Parti Politike: LSI(K.Kolndreaj),PDIU (Sh.Sulo)

Znj. I. Nano: Mirëmbërëma! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator, janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator Të pranishëm gjithashtu janë Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të administratës së KQZ-së. Të pranishëm janë dhe përfaqësues të partive politike, ju lutem?

Kreshnik Kolndreu, Lëvizja Socialiste për Integrim.

Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU



Znj. I. Nano: Jeni zëvendësues?

Z. K. Kolndreaj, përfaqësues i LSI-së : Po!

Znj. I. Nano: Dakord dhe zoti Shkëlqim Sulo nga PDIU, faleminderit. Atëherë, në rendin e ditës së mbledhjes së Komisionit Rregullator sot kemi një projektvendim “Për miratimin e Udhëzuesit për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në Zonën e Administrimit Zgjedhor, në ndihmë të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”. Ky udhëzues ka formën e një manuali të mirorganizuar lidhur me organizimin, detyrat, përgjegjësitë e KZAZ-së, bashkëpunimin, ndërveprimin e saj me KQZ-në, KQV-në, organe të tjera. Bashkëveprimin, komunikimin me partitë politike, institucionet shtetërore, me mediat, Policinë e Shtetit. Organizimin dhe përgatitjen e vendeve të numërimit të votave, dërgimin e materialeve zgjedhore etj. Janë disa rubrika të cilat ndahen në 12 krerë. Lidhur me aktin do të ftoja Sekretarin e Përgjithshëm të KQZ-së, zotin Ylli Merkaj, të prezantonte aktin dhe relacionin në mënyrë të përmbledhur, zoti Merkaj!

Z. Y. Merkaj: Faleminderit, Udhëzuesi “Për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në KZAZ”, së bashku me Kodin Zgjedhor dhe aktet e tjera nënligjore të KQZ-së do të përdoren si kurse e trajnimi të trajnerëve të KQZ-së, dhe të anëtarëve të KZAZ-ve. Udhëzuesi “Për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në ZAZ” së bashku me Fletoren e punës së KZAZ-së me modele të dokumentacionit të punës së saj dhe shembuj praktikë, qartësojnë detyrat e KZAZ-së, nga momenti i ngritjes deri në dorëzimin e materialeve të votimit nga KQV-ja në KZAZ. Ai synon t’ju vijë në ndihmë anëtarëve të KZAZ-ve për veprimtarinë e tyre në administrimin e procesit zgjedhor në ZAZ. Udhëzuesi i KZAZ-së përbëhet nga 12 krerë, të strukturuar në ndarje sipas:

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.04.03.2021*

Kreu I - Paraqet koncepte ligjore të përgjithshme që lidhen me sistemin e zgjedhjeve për Kuvendin, zonën zgjedhore, subjektin zgjedhor, kandidatin dhe zonën e administrimit zgjedhor dhe mënyrën e votimit nga zgjedhësi. Gjithashtu, paraqiten kompetencat e KQZ-së për verifikimin dhe nxjerrjen e rezultatit si dhe përllogaritjen e shpërndarjes së mandateve për çdo zonë zgjedhore.

Kreu II - në 8 nën ndarje, qartëson kompetencat e KQZ-së, si institucioni përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve dhe kompetencat e organeve drejtuese të KQZ-së. Gjithashtu, paraqitet edhe në formë grafike hierarkia e administratës zgjedhore, detyrat kryesore të çdo niveli të saj, për të qartësuar rolet, përgjegjësitë, ndërvarësinë dhe ndërveprimin.


Kreu III – përbëhet nga 12 nën ndarje, qartësohen detyrat dhe përgjegjësitë e KZAZ-së, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të saj. Të drejtat dhe detyrat e anëtarit dhe sekretarit të KZAZ-së, të paraqitura në formë tabelare, evidentojnë qartë të përbashkëtat e këtyre dy funksioneve si dhe detyrat specifike. Detyrat e KZAZ-së, referojnë parashikimet e nenit 33 të Kodit Zgjedhor, nenit 15 të “Rregullores së organizimit dhe funksionimit të KZAZ-së”. Në mënyrë të detajuar, duke evidentuar qartësisht detyrat dhe të drejtat për çdo funksion, paraqiten rregullat për thirrjen, përgatitjen, zhvillimin e mbledhjeve të KZAZ-së, diskutimet, paraqitjen e propozimeve dhe votimin e tyre, marrjen e vendimeve si dhe afatin për zbardhjen dhe publikimin e tyre.

Kreu IV përbëhet nga 6 nën ndarje, ku trajtohet bashkëpunimi, komunikimi, ndërveprimi i KZAZ-së me KQZ-në, Policinë e Shtetit, partitë politike si dhe institucionet në nivel lokal dhe media.

Kreu V- përbëhet nga dy nënndarje, jep informacion për tri formatet e listës së zgjedhësve, përmbajtjen dhe përdorimin e secilit prej tyre, si dhe afatin kur KZAZ-së i dërgohen ato nga kryetari i bashkisë. Aty pasqyrohen:

- veprimet dhe procedurat për të korigjuar pasaktësitë në listën e zgjedhësve dhe

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.04.03.2021*

- e drejta e zgjedhësit për të paraqitur kërkesë në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës deri 24 orë përpara datës së zgjedhjeve.

Kreu VI – trajton procedurat për pranimin, shqyrtimin e kërkesave të subjekteve zgjedhore për akreditim të vëzhguesve, duke përcaktuar:

- afatet e paraqitjes;
- kushtet për të qenë vëzhgues,
- kohëzgjatja e mandatit të vëzhguesit sipas autorizimit të lëshuar nga Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor.

Kreu VII – përshkruan në mënyrë të detajuar detyrat e KZAZ-së për ngritjen e KQV-ve, duke qartësuar:


- të drejtën e partive politike, për të autorizuar degët lokale të tyre për të paraqitur kandidaturat për anëtarë të KQV-ve;
- caktimin e partisë politike që do të propozojë anëtarin e shtatë të Komisionit të Qendrave të Votimit, sipas procedurës përkatëse;
- veprimet procedurale për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të KQV-ve, së bashku me afatet për çdo veprim të KZAZ-së;

Si dhe rastet kur KQV-ja ka mbetur pa kuorum dhe me kalimin e afateve, theksohet kompetenca e KZAZ-së për të urdhëruar KQV-në përkatëse të vazhdojë procedurat dhe marrjen e masave për plotësimin kryesisht të vakancës duke emëruar kryesisht anëtarë të KQV-së deri në plotësimin e numrit të nevojshëm të anëtarëve për vendimmarrje.

Kreu VIII- përshkruan në mënyrë të detajuar detyrat e KZAZ-së për organizimin dhe përgatitjen e VNV-së, masat që merr ajo në bashkëpunim me organet e vetëqeverisjes vendore, për krijimin e kushteve të përshtatshme për procesin e numërimit të votave. Paraqitja e skemës organizative të funksionimit të VNV-së, sipas planvendosjes duke respektuar kriteret për hapësira të veçanta, ku:

- do të vendosen tavolinat e numërimit;
- do të vendosen kutitë e votimit;

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.04.03.2021*

- do të qëndrojnë vëzhguesit e akredituar;
- do të afishohen kopje të tabelës së rezultatit të qendrave të votimit, të vulosura nga sekretari i KZAZ-së.

Kreu IX – pasqyron afatet, procedurat dhe dokumentacionin për dorëzimin e bazës materiale zgjedhore nga KQZ në KZAZ, nga KZAZ për KQV.

Kreu X – qartëson veprimtarinë e KZAZ-së në ditën e zgjedhjeve, duke theksuar detyrimin për hartimin e planit për ndjekjen dhe monitorimin e procesit zgjedhor në të gjitha QV-të.

Kreu XI - në kuadër të përgjegjësive të anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së gjatë ushtrimit të detyrës, pasqyron sanksionet administrative në rast të shkeljes së përcaktimeve të Kodit Zgjedhor dhe dënimet penale në rast të kryerjes së veprimeve që përbëjnë elementë të veprës penale. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim dhe dokumentacionin përkatës manualin e KZAZ-së, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.04.03.2021*

Znj. I. Nano: Zoti Merkaj, faleminderit! Sipas rregullores do duhet të çelim diskutimin në parim të projektaktit. Ndërkohë më lejoni të tërheq vëmendjen përfaqësuesve të partive politike, të cilët janë pa maskë. Ndërkohë që qoftë administrata, qoftë ne... Faleminderit! Atëhere të nderuar kolegë çelim diskutimin në parim lidhur me projektvendimin "Për miratimin e udhëzuesit për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në Zonën e Administrimit Zgjedhor në ndihmë të KZAZ për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë të datës 25 Prill 2021". Po zoti Çakaj!


Z. M. Çakaj: Po e nderuar! Atëhere unë kisha dy diskutime, dy çështje jashtë rendit të ditës në fakt. Po e filloj me çështjen e parë, në këndvështimin tim, por besoj biem dakord të gjithë ne në cilësinë e anëtarëve të Komisionit Rregullator organ drejtues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili ka si tagër miratimin e akteve normative. Pra në këndvështimin tim një nga aktet kryesore....

Znj. I. Nano: Ndjesë zoti Çakaj! Unë çela diskutimin në parim, dëshironi që të mbarojmë diskutimin për....

Z. M. Çakaj: E zhvillojmë pak më vonë atë, në fakt doja ta merrja fjalën përpara zotit Merkaj. Megjithatë sepse është çështje jashtë rendit të ditës, referuar edhe rregullores, ne mund të diskutojmë çështje jashtë rendit të ditës...

Znj. I. Nano: Patjetër që mund të diskutojmë, po flas vetëm për rradhën e diskutimit. Pra...

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.04.03.2021*

Z. M. Çakaj: Atëhere, që mos të shfokusohe mi më pas, ezaurojmë këto çështjet jashtë rendit të ditës dhe më pas fokusohemi tek akti.

Znj. I. Nano: Jo, fokusin e kemi tek akti, sepse akti u prezantua, çelim diskutimin në parim, mendoj që është një akt që

Z. M. Çakaj: Atëhere, për aktin nuk kam për të diskutuar asnjë lloj gjëje në parim. Kam për të diskutuar dy çështje jashtë rendit të ditës. Kështu që ju lutem më lejoni...

Znj. I. Nano: Dakord, nëse është e mundur, nëse është e mundur të vijojmë me aktin. Mendoj që nuk do kemi shumë diskutime për aktin, dhe pastaj i japim kohë vetes për çdo diskutim jashtë rendit të ditës.

Z. M. Çakaj: Po edhe për koherencë do të ishte mirë që të diskutohen këto çështje jashtë rendit të ditës dhe më pas vijojmë me aktin dhe mbarojmë me aktin. Kështu që mos të shfokusohe mi, janë dy çështje të cilat unë ...

Znj. I. Nano: Gjithsesi unë kuptoj këmbnguljen tuaj por jo logjikën në këtë rast. Se shfokusimi do ishte duke qenë se nisëm me aktin të vijojmë me aktin. Megjithatë ato që keni për të diskutuar për çështje jashtë rendit të ditës, jeni i lirë ti diskutoni!

Z. M. Çakaj: Faleminderit! Atëherë, një nga aktet kryesore që ka miratuar Komisioni Rregullator, në gjykimin tim personal, por besoj për këtë biem dakord që të gjithë është vendimi nr.9 datë 24 Dhjetor i vitit 2020. I cili ka të bëjë me veprimtaritë e ndaluara, të kryera nga institucionet shtetërtore dhe në nenin 3 të këtij akti janë parashikuar të gjithë institucionet, lista me institucionet dhe lista me

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.04.03.2021*

zyrtarët të cilat kryejnë veprimtaritë e ndaluara. Në gjykimin tim personal, por besoj të njëjtin shqetësim ndajmë edhe me kolegen Vukaj, me keq ardhje them se ky akt ka dështuar totalisht. Pse ka dështuar totalisht?! Mjafton të hapim televizionet, mjafton të hapim mediat vizive, audiovizive, dhe nga data 24 Dhjetor - 25 Dhjetor që ka filluar, që ka hyrë në fuqi ky akt, e deri më tani që po bëjmë këtë diskutim, nuk ka gjë tjetër vetëm veprimtari të ndaluar. Veprimtari e ndaluar ka ndryshuar formë, më përpara bëhej me leje legalizimi, bëhej me shpërndarjen e çertikateve të pronësisë. Pas denoncimeve fillon me çelsa, me kuti llokumesh apo me kuti bajamesh, dhe vazhdon më tej, ku e di unë me se, prite kur të vij ndonjëhere me thes me çfarë do lloj gjëje. Qëllimi i ligjvënësit, unë dhe zoti Çaka kemi qenë, kemi pasur fatin të jemi edhe në cilësinë e ekspertëve zgjedhor në Këshillin Politik i cili ka prodhuar këto ndryshime dhe jemi të vetëdijshëm për faktin se qëllimi i ligjvënësit kur ka ndryshuar nenet 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor kanë qenë pikërisht barazia e armëve në një proces zgjedhor. Sigurisht në një proces zgjedhor 4 muaj përpara, por edhe gjatë fushatës zgjedhore avantazhin si rregull e ka mazhoranca. Pikërisht me këtë, me këto ndryshime në nenin 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor kjo mazhorancë vetë e ka miratuar është vetë kufizuar. Pikërisht këto ndryshime neni 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor ne e kemi materializuar në vendimin tonë. Por çfarë ka ndodhur?! Ka ndodhur që ky akt është i pazbatueshëm. Ky akt ka humbur të gjithë fuqinë, jo më larg se para disa ditësh edhe një organizatë në gjykimin tim, shumë prestigjoze që merret me çështje zgjedhore “Instituti i Studimeve Politike”, ka paraqitur një kërkesë zyrtare pranë nesh si Komision Rregullator, me qëllim amendimin e këtij vendimi. Nuk po zgjatem më shumë, në gjykimin tim është i vetmi dhe ndjej keqardhje të thellë, është i vetmi akt i cili nuk po gjen zbatim, akt normativ që nuk po gjen zbatim. Ky është një akt thelbësor sepse cënon drejtëpërdrejt garën, cënon drejtëpërdrejt barazinë e armëve në një garë elektorale të drejtë dhe të paanshme. Kështu që në

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.04.03.2021*

këto kushte sigurisht që në ditët në vijim do kemi edhe propozime, në këto kushte ju ftoj edhe juve që së pari nëse keni propozime konkrete, jemi dakord që ti shqyrtojmë, diskutojmë dhe pse jo t'i miratojmë pra ta bëjmë të aplikueshëm, të zbatueshëm këtë akt dhe së dyti do të doja, që një nga elementët kryesor që do t'i shërbente këtij akti të ishte edhe e drejta e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Pra, të parashikohet në akt që të gjykojë kryesisht gjithë shkeljet, gjithë veprimtaritë e ndaluara, deri më tani nuk e ka. Pra, funksionon në bazë të ankesave të subjekteve zgjedhore apo të palëve të treta? Konstatoj dhe konstatojmë ditë për ditë, 24 orë në ditë se të gjithë zyrtarët nga i pari tek i fundit të identifikuar në nenin 3 kryejnë veprimtari të ndaluara. Kjo ishte pikë e parë e Nderuar, jashtë rendit të ditës. Pikë e dytë është një çështje që besoj është shqetësim për të gjithë ne, është vlefshmëria e dokumenteve të identifikimit në zgjedhje. Kodi Zgjedhor e ka parashikuar qartë që dy dokumentet e vlefshme me të cilët mund të shkojë zgjedhësi dhe të paraqitet në qendrën e votimit janë karta e identitetit dhe pasaporta. Në informacionin e fundit që na është paraqitur para disa javësh nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile na rezulton se ka diku tek rreth 800 mijë zgjedhës Shqiptarë, shtetas apo zgjedhës, të cilët nuk e kanë zgjatur afatin, pra u ka skaduar dokumenti i identifikimit, nuk e kanë rinovuar. Në këto kushte unë i referohem edhe Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i kërkoj që urgjentisht t'i drejtohem me shkresë dhe brenda mbledhjes së ardhshme të kemi një informacion të qartë se sa është numri i shtetasve që nuk e kanë rinovuar dokumentin e identifikimit. Nga ana tjetër i kërkoj Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve që në mënyrë urgjente t'i drejtohet institucioneve të cilat e kanë si përgjegjësi, qoftë edhe Qeverisë Shqiptare apo Ministrisë së Brendshme nëse ka një vendimmarrje për zgjatjen e vlefshmërisë së tyre siç u bë në kushtet e pandemisë. Në mënyrë që të ushtrohet e drejta Kushtetuese e votës. Një nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Ju faleminderit e Nderuar, kaq kisha!

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.04.03.2021*

Znj.I.Nano: Faleminderit zoti Çakaj! Zonja Vukaj po!

Znj.H.Vukaj: Në vijim të çfarë parashtroi zoti Çakaj, e gjej jo me vend por të domosdoshme për ta vijuar diskutimin pavarësisht se në rend ai mori fjalën e pari. Këto janë shqetësime që i kemi diskutuar edhe më herët, shqetësime të cilat ju ftoj që mos t'i lemë as në ftohje as në pazbatueshmëri, apo në rrugën që po merr akti. Akti realisht ka rënë në pazbatueshmëri, pra akti për veprimtaritë e ndaluara, nuk prodhon as në minimumin e garancive që duhet të prodhonte apo që kanë rënë dakord palët politike. Si i tillë, natyrisht po kthehet në një ogur të keq dhe do të thosha që jo vetëm që nuk siguron qytetarët shqiptarë për, le të them zgjedhje të paanshme ose të pandikuara. Por tashmë është kthyer në një akt i cili nuk përfilllet për t'i konsideruar le të them zgjedhjet e shenjta ose të pa ndikuara. Nga mëngjesi deri në mbrëmje po të shohim nëpër televizione kemi vetëm veprimtari të ndaluara të cilat promovohen, nxiten, lançohen tendera, lançohen prokurime publike, të cilat po të hapësh përmbatjen e vendimit janë totalisht të ndaluara dhe janë të qarta nga kushdo si për subjektet elektorale ashtu edhe për aplikantët e këtij akti që janë të dënueshme, pra sipas këtij akti. Për më tepër ajo që gjej me vend për ta trumbetuar është fakti që përtej këtij akti kemi rënë në precedentin e paprecedent. Atë të një organi paralel i cili në meritë ndoshta të njëanshmërisë apo të shumicës së votave që mund të kenë, arrijnë deri në interpretimin e akteve tona ose ku di unë në sofizma të cilat as Kodi Zgjedhor vetë nuk i përmban si e si që t'i shmangin apo t'i favorizojnë subjektet apo individët, të cilët janë kompetentë për të pasur funksione në dorë apo për të dhënë attribute, të drejta, të cilat detyrimisht ndikojnë në këtë periudhë. Për sa i përket pikës së dytë, të cilën unë jashtë rendit të ditës, në një nga mbledhjet pararendëse e shtrova atë të dokumentave të identifikimit, të cilat ishin në një numër alarmant dhe që

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.04.03.2021*

skadonin dhe që rrezikonin thuajse 1 milion shtetas të mbeteshin pa votuar ose të beheshin precedent i kapjes nga të tretët të cilët ndoshta synojnë të kapin procesin zgjedhor. Nuk kemi deri tani asnjë lloj le të them indikator shkresor apo përcjellje shkresore minimalisht, për ta vënë në lëvizje apo për të marrë përgjigjen përfundimtare për shtyrjen e afatit të kartave të identitetit apo dokumentave të tjera të identifikimit. Konsideroj që zëri ynë apo çfarë parashtruar në këtë seancë dëgjimore të merret në konsideratë dhe të zgjidhet sa më parë sepse siç e dimë vota është e shenjtë po kështu edhe e drejta për të votuar, faleminderit!

Znj.I.Nano: Zonja Vukaj, faleminderit! Kolegë të tjerë kanë diçka për të... po zoti Çaka!

Z.D.Çaka: Atëhere, faleminderit zonja Kryetare. Duke marrë shkas edhe nga diskutimet e dy kolegëve do të doja që edhe unë të jepja një vlerësimin tim në lidhje me këto pika. Për sa i përket çështjes së parë që u ngrit edhe nga kolegët dhe rëndësisë së aktit për veprimtaritë e ndaluara biem të gjithë dakord që ai është një ndër aktet më të rëndësishme që Komisioni Rregullator ka miratuar. Megjithatë personalisht mendoj se ky akt absolutisht është duke arritur atë çfarë ne kemi normuar dhe të themi që ka pasur apo nuk ka pasur veprimtari të ndaluar nga subjekte të ndryshme, mendoj që ne vetë si Komision Rregullator këtë të drejtë, këtë kompetencë ia kemi caktuar strukturave të tjera në rradhë të parë Komisionerit Shtetëror dhe më pas subjektet të interesuara mund ta ankimojnë atë pranë Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve. Më pas mund të shkohet në gjykatë, e cila ka pasur edhe praktika pavarësisht vendimmarrjes për ne është e parëndësishme se si është ajo vendimmarrje të paktën si Komision Rregullator. Mesa jam në dijeni sot ka pasur edhe një vendimmarrje të Kolegjit Zgjedhor, mbase jam i gabuar po kështu

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.04.03.2021*

kam një informacion paraprak që e ka çuar për kompetencë tek Gjykata Administrative. Kështu mendoj, që të hyjmë në kompetencat e strukturave të tjera homologe tona në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve apo edhe në vendimet e gjykatës mendoj që jo vetëm nuk do t'i shërbejë punës sonë si komision, por mbi të gjitha edhe vetë procesit. Për sa i përket asaj që zoti Çakaj theksoi që të jetë kryesisht Komisioneri Shtetëror i Zgjidhjeve që të shqyrtojë veprimtaritë e ndaluara nuk mendoj se kjo do të jetë sot pengesë për të pasur ankesa nga çdo subjekt qoftë politik, apo çdo subjekt i interesuar. Nuk mendoj se është ky ndonjë shkak që mund të pengojë nëse ka raste të asaj që mund të pretendohet si shkelje. Kështu që vlerësoj që gjithësecili prej nesh ka të drejtën e tij për të bërë sugjerime, por mendoj që të jemi pak koherentë në ndarjen edhe të kompetencave në raport me strukturat e tjera. Për sa i përket pikës së dytë të asaj të dokumentave të identifikimit është e vërtetë që ka pasur një vlerësim edhe në media për këtë fakt, megjithatë dua të theksoj që është e rëndësishme që çdo qytetar të votoj. Por unë mendoj që kur japim shifra mbase të jemi edhe më koherentë në lidhje me faktet që parashtrohen, absolutisht që çdo subjekt, çdo person ka të drejtën që të votojë.

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



Z. D .Çaka: Absolutisht që çdo subjekt, çdo person ka të drejtën që të votoj, por jo apriori ky është vlersimi im personal, çdo person i cili nuk ka kartën e identitetit, pra që mund të jenë rreth 800 mijë, absolutisht është person i cili nuk mundet të votojë. Sepse e dimë të gjithë, që Kodi Zgjedhor ka njohur dy dokumenta për të votuar. Pra mund të mos ketë kartën, por mund të ketë pasaportën, ose mund të mos ketë pasaportën, por mund të ketë kartën. Ndërkohë nga informacionet që unë kam, rreth 175 mijë shtetas shqiptarë, mbi të gjitha zgjedhës, nuk e kanë bërë asnjëherë as kartën dhe as pasaportën në të gjithë jetën e tyre. Por kjo nuk do të thotë që çdo strukturë duke përfshirë dhe KQZ mos të bejë ftesë çdo qytetari që të shkojë të aplikojë dhe besoj që kjo është bërë si nga Komisioneri Shtetëror, madje dhe nga ne si anëtarë të gjithë këtu! Në komunikimet që kemi pasur me mediat, duke i bërë thirrje çdo qytetari që të bejë sa më shpejt rinovimin e këtyre dokumentave. Pastaj nëse do të jetë apo jo shtyrja e afatit të tyre pjesë e një vendimmarrje të atyre strukturave që ju takojnë, besoj që ne si KQZ do reflektojmë atë vendimmarrje që ju takon atyre, organeve që e kanë këtë kompetencë. Ndërkohë jo se e drejta për informimin nuk prevalon dhe secili nga ne ka të drejtën të kërkojë informacion dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, por mendoj që nga pikpamja e strukturës si Komision Rregullator nuk do na inpaktojë në një vendimmarrjen tonë një kërkesë ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për të pasur se sa do të jetë numri i shtetasve që në këto momente nuk kanë dokumente identifikimi. Ndërkohë pjesën tjetër unë besoj që edhe Komisioneri Shtetëror dhe stafi KQZ-së, kanë pasur komunikime edhe me institucione të tjera dhe besoj që kjo është më shumë se e rëndësishme, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit z.Çaka! Nëse më lejoni dhe mua të adresoj edhe unë këto dy shqetësime që u ngritën nga kolegët dhe që i vlersoj jashtëzakonisht. Sa



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.04.03.2021*

i përket qoftë veprimtarisë të Komisionit Rregullator, në kuptimin e zbatueshmërisë së vendimeve të tij, qoftë edhe çështja tjetër që në fakt përbën shqetësim për gjithë publikun. Po e nis nga kjo e dyta dhe nëse më lejoni po propozoj, meqë këtu është i pranishëm Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, ta transmetojë këtë shqetësim te Komisioneri Shtetërorë i Zgjedhjeve, i cili përfaqëson institucionin me të tretët në mënyrë që të kemi një informacion më të përditësuar për atë. Qoftë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile apo nga institucione të tjera. Për atë se sa është numri i shtetasve të cilët për shkak se ju ka mbaruar afati i një prej dy dokumenave të identifikimit. Me anë të cilave mund të votojnë nuk pa mundësohet për këtë shkak votimi dhe nëse ka edhe veprimtari të tjera të Komisionerit, përveç thirrjeve publike, deklaratave publike të tij! Nëse mund të marrim një informacion nga institucionet përkatëse, për alternativa të mundshme për të zgjidhur këtë problematikë. Lidhur me çështjen e parë që diskutoj z.Çakaj jashtë rendit të ditës. Lidhur me vendimin tonë për veprimtaritë e ndaluara. Do doja vetëm një moment të thoj: “Që në nenin 9-të, të këtij vendimi, ne ja kemi lënë Komisionerit që mundet edhe kryesisht edhe me kërkesë të tretëve”. Megjithatë nëse do të formalizohet një propozim për ndryshime konkrete në vendim, sigurisht që Komisioni Rregullator është i detyruar ta shqyrtojë gjithmonë në funksion të përmbushjes së qëllimit të vendimit për veprimtaritë e ndaluara! Z.Çela ju kishit diçka?

Z. A. Çela: Faleminderit e nderuar! Bashkohem edhe unë terësisht me parafolësin kolegun Çaka për sa i përket çështjes së parë. Nuk na takon neve mendoj dhe unë që të pargjykojmë vendimet e KAS-it. Ndërsa për sa i përket çështjes së dytë të zgjedhësve që janë pa ID dhe pa pasaportë, mendoj që thirrjet janë berë të mjaftueshme si nga mediat nga Ministria e Brendshme, si dhe nga Komisioni Qendror që të pajisen me Karta. Por nuk besoj që të jetë numri aq i lartë dhe shtetasit të kenë si pashaportën si ID të skaduar. E vetmja gjë ka ngelur

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



tani që ti marësh prej xhaketa, prej dore dhe ti çosh te Aleati që të aplikojnë. Më shumë se kaq, se thirrjes nuk e di se çfarë mund të bëjmë gjithsesi Komisioneri.

Znj. I. Nano: Faleminderit z.Çela, atëhere unë personalisht si anëtare e Komisionit Rregullator dhe si Kryetare po e përsëris kërkesën për Sekretarin e Përgjithshëm për ti transmetuar shqetësimin e dytë Komisionerit Shtetëror të zgjedhjeve! Po z.Merkaj?

Z. Y. Merkaj: Po, patjetër ne do ja transmetojmë Komisionerit!

Znj. I. Nano: Po faleminderit, faleminderit! Po z.Çakaj?

Z. M. Çakaj: Për sqarim! Së pari, është e vërtetë që në nenin 9-të, Ndalimi i veprimtarive nga KQZ-ja, të vendimit nr.9-të. Parashikohet norma se: "Në rast se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve kryesisht ose me kërkesë të tretëve konstaton se veprimtaria publike përbën veprimtari të ndaluar sipas nenit 3 të këtij vendimi"! Çfarë ka ndodhur deri tani? Kemi ndonjë vendim kryesisht?! Zero, pra është i pa aplikueshëm?! Ju ka rënë në nulitet ky vendim? Çfarë ka ndodhur me denoncimet?! Deri me tani kemi vetëm dy vendimmarrje. Çfarë po ndodh realisht 24 orë në 24? 24 orë në 24 veprimtari të ndaluara! Shpërndajnë çelsa, mollë, portokalle, është veprimtari e ndaluar, është veprimtari e ndaluar nuk diskutohet! E ka parashikuar dhe ligjvënësi e ka parashikuar dhe vendimi ynë, të 5-të e kemi miratuar në unanimitet! Besoj kjo është e qartë!



Z. M. Çakaj: Në këto kushte do t'u riftoja ta rishikojmë dhe këtë vendim që kemi miratuar për arsye se nuk prodhon asnjë efekt ligjor. Nuk merrem absolutisht me gjykimin e institucioneve qoftë dhe organeve të tjera të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve apo aq më tepër gjykatave përtej opinionit individual nuk i takon kësaj tryeze, besoj. Megjithatë kthehem tek çështja e dytë "Dokumentet e identifikimit" qoftë kartat e identitetit qoftë pasaportat biometrike. Nuk ka nevojë, besoj të marrim njeri prej krahu ta çojmë tek zyrat e ALEAT-it. Ka incentiva të shumta në numër dhe të larmishme që qeveria apo institucionet shtetërore mund t'i bëjnë gjithë këtyre shtetasve shqiptarë të cilët nuk e kanë mundësinë, të cilët nuk e shohin të arsyeshme, por të cilët duan ta ushtrojnë të drejtën e votës. E ritheksoj edhe njëherë që një nga lirit dhe të drejtat themelore të njeriut është e drejta e tij politike, liri politike. Po si materializohet kjo? Në Kushtetutën e Republikës të Shqipërisë parashikohet që kjo liri dhe e drejtë politike materializohet nëpërmjet votës. Çdo katër vjet për pushtetin qendror për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë dhe çdo katër vjet për zgjedhjet për pushtetin vendor. Në këto kushte minimumi që unë besoj, mund t'i drejtohem, mund të dalë nga kjo tryezë t'i drejtohem Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili përfaqëson institucionin e KQZ-së në marrëdhënie me të tretët, qoftë Ministrin e Brendshëm, qoftë Qeverinë Shqiptare është që të kërkohet zgjatja apo vlefshmëria. Nuk po them incentiva të tjera si për shembull të hapen pika të tjera (nuk kuptohet), sepse mund të ketë kosto të tjera financiare apo të subvencionoi një pjesë ose të gjithë pagesën për aplikimin për kartën e identiteti apo pasaportë biometrike, por ka mënyra.. ka shumë mënyra. Nga ana tjetër, unë nuk e kam këtë informacion që 175,000 nuk e kanë. Nuk e di, nuk e kam ditur. Unë kam informacion që në 31/12/2020 numri i shtetaseve shqiptare me dokumente të pa rinovuar ka qenë 1,063,000 nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, është shkresa zyrtare. Nga ana tjetër, me informacion jo zyrtarisht kur kemi komunikuar u bë disa kohë dhe

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.04.03.2021*

koha po shtrëngon janë diku rreth 800,000 përsëri nuk e kemi me shkresë, por edhe 800,000 është një numër i konsiderueshëm. Çështja që shtrohet “A do t’i japim të drejta shqiptarëve që të votojnë?”. Kaq. Ne në Kodin Zgjedhor në tagrin e këtij institucioni e këtij organi drejtues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë pikërisht administrimi i zgjedhjeve, përcaktimi i rregullave, njësimi praktikave zgjedhore si dhe bashkorganizimi dhe funksionimi, bashkërendimi i çështjeve së bashku me institucionet shtetërore për miradministrimin e zgjedhjeve. Pra, ne kemi tagër. Qoftë dhe nëpërmjet Komisionerit që përfaqëson Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Kështu që në këto kushte besoj të biem dakord të gjithë që t’i drejtohem Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile apo Ministrisë së Brendshme apo Qeverisë Shqiptare të ketë një vendimmarrje dhe kjo vendimmarrje të jetë sa më e shpejtë.

Znj. I. Nano: Atëherë zoti Çakaj besoj që unë të paktën këtë shqetësim e përcolla tek Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së. Kështu që në të njëjtën valë jemi për këtë shqetësim për t’ia përcjellë Komisionerit, i cili pastaj të vendosi kontaktet me institucionet përkatëse. Atëherë të nderuar kolegë ...

Z. M. Çakaj: Jam dakord me Ju, por e kisha me kolegët.

Znj. H. Vukaj: Do t’u lutesha dhe diçka tjetër.

Znj. I. Nano: Po zonja Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Në vijim të çfarë kolegët parashtruan për njohje kompetencash apo jo i bëj me dije kolegët që jo vetëm i njohim kompetencat, iluminojmë mbi to, i japim edhe leksione mbi to dhe bëjmë dhe analiza risku se ku qendron

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



cedimi ligjor, çalimi në Kod apo ndërhyrjeje të tjera të cilat janë të paligjshme, të padrejta apo në kapërcim të kompetencave. Siç e dimë aktet tona janë zinxhir i njëra-tjetrës që kanë një qëllim të vetëm garantimin e pacënueshmërisë së zgjedhjeve. Pra, zgjedhje të lira, të ndershme. Kjo është një nga shtyllat tona kryesore të paktën e imja personale, por edhe e kolegëve që e mbështesin. Kështu që në meritë të kësaj, diskutimi ishte jo vetëm i domosdoshëm, por edhe mund t'i kalonte caqet e iluminimit apo të analizës së riskut se çfarë ndodh realisht me aktin tonë apo me institucionet paralele, të cilat përbëjnë KQZ-në dhe duhet të kenë një funksion të vetëm. Pra, garantimin e pacënueshmërisë së zgjedhjeve gjë që le për të dëshiruar deri tani, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj! Kolegë kemi çështje të tjera jashtë rendit të ditës? Ka ndonjëri nga ju diçka apo do të vijojmë me diskutimin në parim “Të udhëzuesit për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në zonën e administrimit zgjedhor.” Zoti Çaka dakord.

Z. D. Çaka: Jo nuk ka lidhje me.. doja thjesht një saktësim, sepse të paktën nga z. Çakaj u shtua si kërkesë pra që t'i drejtohem strukturave shtetërore për të kërkuar zgjatjen e afatit, besoj që kjo kërkesa nëse jam i saktë. Ndërkohë besoj që kërkesa Juaj Kryetare drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ishte në lidhje me faktin e kërkesës së një informacioni lidhur me numrin e subjekteve dhe jo një propozim i Komisionit Rregullator në lidhje me shtyrjen e afatit apo jo? Nëse e kam kuptuar unë drejt. Është thjesht çështje saktësimi, faleminderit!

Znj. I. Nano: Sigurisht Komisioni Rregullator nuk mund të paragjykojë çfarëdolloj alternative që mundëson votimin e cilitdo shtetas që ka pamundësi objektive për të votuar. Nuk jemi ne që japim alternativat po minimalisht ju drejtohem institucioneve, gjithmonë nëpërmjet Komisionerit e para për të ditur



një numër të saktë të zgjedhësve deri në këtë moment të cilëve për shkak të skadimit të afatit u pamundësohet ose e njëjës ose e tjetrës.

Znj. H. Vukaj: Dhe çfarë ka bërë Drejtorja e Gjendjes Civile deri tani sepse e kemi kërkuar dhe më herët këtë.

Znj. I. Nano: E kemi kërkuar dhe herë të tjera, por alternativat sigurisht i vlerësojnë institucionet dhe është *(nuk dëgjohet)*.

Z. D. Çaka: Kërkesën e informacionit që mund të tregojnë për gjendjen aktuale dhe unë jam dakord thjesht duke marrë parasysh kërkesën e z. Çakaj prandaj ishte më shumë për sqarim, faleminderit!

Znj. I. Nano: Dakord, atëherë rikthehem tek akti..

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU: Më fal zonja Kryetare, në lidhje me..

Znj. I. Nano: Nuk ju ka dhënë fjalën zoti Sulo. Dëshironi të merrni fjalën në lidhje me çfarë?

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU: Në lidhje me këto dy shqetësimet..

Znj. I. Nano: Ju keni ndonjë çështje tjetër jashtë rendit të ditës për të trajtuar?

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU: Jo.

Znj. I. Nano: Do.. kjo çështje besoj u shqyrtua që do të thotë të gjithë e kemi të njëjtin shqetësim për kartat e identiteti, për pamundësinë e votimit të shtetaseve



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.04.03.2021*

besoj që ky është një shqetësim qytetar në rradhë të parë dhe pastaj dhe institucional.

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU: Do të ishte një skandal i madh për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve zonja Kryetare në qoftë se do të jenë 800,000 shqiptarë.

Znj. I. Nano: Nuk është skandal fare për mua si Komision Rregullator! Si Komision Rregullator ne jemi duke e shtruar këtë çështje duke e diskutuar duke e adresuar! Në qoftë se diku në Kodin Zgjedhor ju si përfaqësues i një partie politike më gjeni një tagër të Komisionit që të shtyjë afatin e kartave të identitetit, më thuaj dhe e shqyrtojmë që në këtë mbledhje jo në të ardhshmen! Ne jemi duke sensibilizuar duke kërkuar informacion kështu që fjalën turp i madh të lutem mos e përdor në këtë mbledhje!


Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU: Thash “skandal” jo “turp i madh”.

Znj. I. Nano: As skandal nuk është për ne si Rregullator!

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU: Unë dëgjoj zonja Kryetare. Mendoj se nuk është kjo forma e komunikimit të lutem.

Z. I. Nano: Të lutem, keni diskutim jashtë rendit të ditës dhe unë moderoj këtu mbledhjen dhe ju jap fjalën. Po të përdorim terminologji të tillë “skandal”, “turp”, etj., për një çështje që nuk është në tagrin tonë. Ne në tagrin tonë po bëjmë atë që kemi bërë dhe herë të tjera sensibilizim, përcjellje e shqetësimit dhe nuk është skandal për KQZ-në ky. Në qoftë se është skandal gjithmonë...

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU: Do të ishte..

Z. D. Çaka: Zonja Kryetare mundet të.. *(nuk dëgjohet)* tani nuk mundet të flasë.

Znj. I. Nano: Atëherë unë do të doja ta mbyllnim diskutimin.

Z. D. Çaka: Kur flet një anëtar i Komisionit dhe mbi të gjitha Kryetari që drejton nuk mund të ketë ndërhyrje qoftë të përfaqësueseve të partive politike. Ne nuk po ndërhyrë me njeri-tjetrin.

Znj. I. Nano: Sigurisht zoti Çaka jemi pesë anëtarë të Komisionit Rregullator që i adresuam të dy problemet. Nuk kishim diçka një propozim konkret ishin shqetësime të adresuara, përcollëm shqetësimet dhe tek Administrata e KQZ-së dhe këtu mbyllim diskutimet jashtë rendit të ditës dhe vijomë me diskutimin në parim për projektaktin.

Të nderuar kolegë lidhur me udhëzuesin keni diçka në parim? Më tej e marrin fjalën nëse dëshirojnë përfaqësuesit e partive politike. Të nderuar kolegë? Dakord nëse keni diçka ju lutem përfaqësuesi i PDIU dhe LSI lidhur me aktin në parim?

Z. K. Kolndreaj, përfaqësues i LSI: Jo, e Nderur.

Znj. I. Nano: Faleminderit! Zoti Sulo?

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU: Jo, nuk kam!

Znj. I. Nano: Faleminderit! Të nderuar kolegë ju ftoj të kalojmë në votimin në parim të projektvendimit “Për miratimin e udhëzuesit për organizimin dhe

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.04.03.2021*

administrimin e procesit zgjedhor ne zonën e administrimit zgjedhor në ndihmë të anëtarëve të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

Kush është dakord në parim me projektaktin?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet në parim projektakti!

Atëherë për ekonomikitet të kohës bëjmë fjalë për një manual prej 57 faqesh dhe gjej rastin të përgëzoj administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe drejtorinë përkatëse që e ka përgatitur, për punën voluminoze, cilësore dhe që mendoj do të jetë një ndihmë shumë e madhe për KZAZ-të në përmbushje të detyrave të tyre gjatë procesit zgjedhor. Do të thoja që veç të tjerash përveç përmbajtjes dhe vizualisht ky udhëzues është interesant dhe që e bën më praktik atë në përdorim. Kështu që për shkak të vëllimit prej gati 60 faqesh duke qenë integral, pra nuk është se kemi një diskutim nen për nen do të preferoja të mos lexoja 60 faqe të manualit, sepse na u prezantua në mënyrë të detajuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, por do të kaloja tek pika 1 e projektvendimit, pra Komisioni Rregullator vendosi:

1. Të miratojë udhëzuesin për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në zonën e administrimit zgjedhor në ndihmë të anëtarëve të KZAZ për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 sipas materiali bashkëlidhur.

Znj. I. Nano: Dakord, nëse nuk kemi diçka atëherë votojmë piken 1.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet pika 1!

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



2. Kundër këtij vendimi mund të behet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë brenda pese ditëve nga shpallja e tij.

Kalojmë në votim.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Votojmë kolegë?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Të pestë anëtarët e Komisionit Rregullator janë dakord. Atëherë miratojmë në tërësi projektvendimin pasi e kemi miratuar në parim dhe pikë për pikë.

Kush është dakord me projektvendimin në tërësi?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet në tërësi projektvendimi!

Atëherë duke qenë se nuk kemi çështje tjetër ne rendin e ditës ato jashtë rendit të ditës u diskutuan paraprakisht më lejoni të deklaroj të mbyllur mbledhjen e Komisionit Rregullator. Natën e mirë!

Vendimi nr.8

